# FLETORJA ZYRTARE

# E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

| Nr.67 | 2005 | 12 shtator |
|---|---|---|

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret nr.4643 datë 30.8.2005 | Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare………………………… | 2369 |
| Dekret nr.4646 datë 7.9.2005 | Për emërimin e Këshillit të Ministrave………………………. | 2369 |
| Akt normativ nr.1 datë 11.9.2005 | Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës për forcat pjesëmarrëse për stërvitjen “Cooperative Engagement 05” dhe zhvillimin e stërvitjes ushtarake ndërkombëtare, të drejtuar nga NATO, “Cooperative Engagement 05”, me pjesëmarrjen e forcave të huaja ushtarake në territorin e Republikës së Shqipërisë……………...……...... | 2370 |
| Vendim i KM nr.582, datë 15.4.2005 | Për disa shtesa në vendimin nr.390, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave “Për ruajtjen dhe sigurimin e disa objekteve shtetërore”, të ndryshuar………………………………………. | 2371 |

**DEKRET**
**Nr.4643, datë 30.8.2005**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Martin Llesh Lucaj
2. Donika Shefqet Lucaj (Agolli)
3. Ervin Loni Dimo
4. Fatjona Idajet Iljazi (Zeqiri)
5. Alketa Kujtim Ferhati (Sulkja)
6. Daniela Altin Ferhati
7. Ilirjan Rrapo Toskaj
8. Selami Reshat Baxhaja
9. Anila Hamit Schorr (Dika)
10. Xhenoina Altin Toska (Guzi)
11. Jacqueline Redjan Toska
12. Arian Ramadan Xheladini
13. Kadri Ibrahim Sala
14. Enkela Robert Plümper (Preni)
15. Adriatik Bardhyl Shehu
16. Fabian Adriatik Shehu
17. Elmira Muharrem Kapaj (Isak)
18. Ilir Robert Kapaj
19. Eni Robert Kapaj
20. Bardh Nikë Lulaj
21. Durim Ibrahim Bajrami
22. Garentina Servet Koçi (Shuli)
23. Michelle Gëzim Koçi
24. Didjana Pullumb Stafa (Tila)
25. Gani Alush Iljazi
26. Gezim Surja Aliu
27. Albert Avni Paçuku
28. Leonat Astrit Shkurti
29. Edmond Sokrat Çomo
30. Chrissy Arben Elezi Qafmolla

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Alfred Moisiu**

**DEKRET**
**Nr.4646, datë 7.9.2005**

**PËR EMËRMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të neneve 93, 96 dhe 98 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit Sali Berisha,

DEKRETOJ:

Neni 1

Emërohet Këshilli i Ministrave me përbërje si më poshtë:

1. Zoti Sali Berisha, Kryeministër.
2. Zoti Ilir Rusmali, Zëvendëskryeministër.

3. Zoti Besnik Mustafaj, Ministër i Punëve të Jashtme.
4. Zonja Arenca Trashani, Ministre e Integrimit.
5. Zoti Sokol Olldashi, Ministër i Brendshëm.
6. Zoti Fatimir Mediu, Ministër i Mbrojtjes.
7. Zoti Ridvan Bode, Ministër i Financave.
8. Zoti Genc Ruli, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
9. Zoti Aldo Bumçi, Ministër i Drejtësisë.
10.Zoti Lulzim Basha, Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
11.Zoti Genc Pollo, Ministër i Arsimit dhe i Shkencës.
12.Zoti Maksim Cikuli, Ministër i Shëndetësisë.
13.Zoti Koço Barka, Ministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
14.Zoti Jemin Gjana, Ministër i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
15.Zoti Bujar Leskaj, Ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
16.Zoti Lufter Xhuveli, Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Alfred Moisiu**

## AKT NORMATIV
## Nr.1, datë 11.9.2005

## PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MNISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE), LIDHUR ME DISPOZITAT E MBËSHTETJES SË VENDIT PRITËS PËR FORCAT PJESËMARRËSE PËR STËRVITJEN "COOPERATIVE ENGAGEMENT 05" DHE ZHVILLIMIN E STËRVITJES USHTARAKE NDËRKOMBËTARE TË DREJTUAR NGA NATO "COOPERATIVE ENGAGEMENT 05", ME PJESËMARRJEN E FORCAVE TË HUAJA USHTARAKE NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 12 pika 3 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (ShAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës për forcat pjesëmarrëse për stërvitjen "Cooperative Engagement 05" dhe zhvillimin e stërvitjes ushtarake ndërkombëtare të drejtuar nga NATO, "Cooperative Engagement 05", me pjesëmarrjen e forcave të huaja ushtarake në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Modalitetet e zhvillimit të stërvitjes dhe statusi i forcave të huaja ushtarake pjesëmarrëse në këtë stërvitje ndërkombëtare do të jenë ato të përcaktuara në memorandumin e mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në

Europë (SHAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës për forcat pjesëmarrëse për stërvitjen "Cooperative Engagement 05", marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, lidhur me statusin e forcave, nënshkruar në Londër më 19 qershor 1951, të ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995 dhe marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut Verior dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre.

Neni 3

Ky aktnormativ hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.582, datë 15.4.2005**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.390, DATË 15.8.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E DISA OBJEKTEVE SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "e" të pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.390, datë 15.8.2002 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa:
1. Në listën bashkëlidhur pas numrit 9, të shtohet numri 10, me këtë përmbajtje:
"10. Godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.".
2. Në pikën 4, pas emërtimit "Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit", të shtohet "Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit.".
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**
Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën**:
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

**BOTIMET:**

| | |
|---|---|
| 1. | KUSHTETUTA (edhe anglisht) |
| 2. | KODI I PROCEDURËS CIVILE |
| 3. | KODI I PROCEDURËS PENALE |
| 4. | KODI PENAL |
| 5. | KODI I PUNËS |
| 6. | KODI I FAMILJES |
| 7. | KODI CIVIL |
| 8. | KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN |
| 9. | KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar) |
| 10. | KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE |
| 11. | DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR |

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

| | |
|---|---|
| 1. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT |
| 2. | PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK |
| 3. | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL |
| 4. | PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË |
| 5. | PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE |

**DOLI NGA SHTYPI:**

**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**
**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**

Doli nga shtypi më 12.9.2005

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 4300 copë | Formati: 60x88/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 50 lekë